



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.2, SH.A**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCES - VERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje detergjent për pastrim dhe lvanteri”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**39831200-8 33711900-6 39832100-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**842,497.00** (tetëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndrshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndrshuar), autoriteti/enti kontraktor **Rezidenca Studentore Universitare Nr.2 Sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e**

prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit datë 05.10.2022 të miratuara nga APP.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3; ne masen 2% te e vlerës së përlllogaritur të kontratës ne nje nga format e parashikuara ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83, perkatesisht ne vleren prej 16,850 lekë pa tvsh.*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, Sipas Shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.1.1.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ( të vlefshme) ose ekuivalentetë tij të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

**2.1.2.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 14001:2015 ( të vlefshme) ose ekuivalentetë tij të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

**Argumentim:** Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën ISO 14001:2015, ose ekuivalente me të ”Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të mjedisit.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2021,2022,2023 e cila duhet të ketë një vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 si dhe nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

**842,497 x 0.4= 336,999 (treqind e trdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.**

Kërkohe vlera jo më pak se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, bazuar në pikë 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi, kjo është një procedurë e Hapur e Thjeshtuar dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ”Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi tëArdhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor të vitit 2021,2022,2023 që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në balancin e kërkuar nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi për paraqitjen e bilancit është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **842,497 x 0.2 = 168,500 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.**

---

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

**842,497 x 0.2 = 168,500 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.**

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra nga lista e artikujve të kërkuar nga preventiv (nga 1 copë/1 artikull) . Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit para Zyres së Protokollit të Autoritetit Kontraktor, ato duhet të jenë të mbyllura në kuti jo transparente të vulosur, së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht skualifikim.

**Mostrat e kërkuara do të jenë:**

Materiale detergjent për zërat nr. 1-3-5-9-13-14-15

Materiale pastrami për zërat nr. 16-17-23-26

*Mallrat e dorezuara të jenë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST. Autoriteti kontraktor pasi të vlerësojë mostrat do tja kthejë operatorit ekonomik në respektim dhe në zbatim të dispozitave të LPP . Vlerësimi i mallrave të dorezuara , mostrave do të jetë kusht për vlerësimin e operatorit ekonomik.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Për efekt të verifikimit të gjendjes gjyqësore Operatorët Ekonomik së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të sjellin edhe fotokopjen e çertifikatës personale të administratorit ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e certifikatës personale të administratorit të shoqërisë ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti).

*Argumentimi: Ky kriter është bazuar në Njoftimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1155prot., datë 01.02.2019 dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.1001/1 prot., datë 01.02.2019).*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike.

### **GRAFIKU I LËVRIMIT**

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Afati</i>
1	Detergjent për pastrim dhe lavanteri	Deri më datë 31.12.2024

### **I. Argumentimi i përlogaritjes së vlerës së fondit limit:**

Lidhur me përlogaritjen e fondit limit total në dispozicion, AK argumenton se, ky fond përbëhet nga buxheti i shoqërisë për vitin 2024. Për përlogaritjen e fondit limit AK i është referuar çmimeve të tregut. Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është ngritur grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së fondit limit referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, neni 76.

### **.II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë*

*cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***